REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr 82 prot.

Kamëz, më 21.9.2026

V E N D I M
Nr.67.Datë 21/9 2026
MBI

"MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË KAMËZ TË DISA PASURIVE DHE PËR DISA SHTESA NË VKM-NË NR.775, DATË 05.09.2013 "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI APO PËRDORIM TË BASHKISË KAMËZ, TË QARKUT TË TIRANËS"

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 21.09.2026, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.61 Datë 16.09.2026 në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr.8743, datë 22.01.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, nenit 3 të ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, të VKM-së nr.28, date 27.01.2023 "Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve", të VKM-së nr. 775, datë 05.09.2013 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave publike të paluajtshme shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kamëz, Qarku Tiranë", **Këshilli Bashkiak Kamëz";**

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Kamëz, të disa pronave të paluajtshme shtetërore, që do të përdoren në fushën e shëndetësisë, zhvillimit ekonomik dhe social të bashkisë, sipas formularëve dhe planeve të rilevimit, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Pas miratimit të vendimit, ndjek zbatimin e tij Drejtoria e Kadastrës, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave dhe Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

Bulevardi "Nënë Tereza" Nr 492 Kamez, tel: +35547200177, e-mail: keshilli.bashkiak@kamza.gov.al www.kamza.gov.al